

MIRËSJELLJA GJUHËSORE DHE FORMAT E SHPREHJES SË SAJ NË SHQIPEN E NË ITALISHTEN

Zakonisht, çdokush prej nesh kryen shkëmbime verbale me persona të tjerë, shkëmbime të cilat, në përgjithësi, nisin a hapen me një përshëndetje verbale ose gjestuale. Përshëndetja shënon, pra, më të parën formë kontakti verbal që në mënyrë konvencionale hap dhe mbyll një bisedë, duke kryer kështu një funksion të rëndësishëm sociolinguistik. Në kontaktet tona të përditshme shfrytëzojmë “zakone” ose praktika që e thjeshtojnë komunikimin dhe që, në disa raste, bëhen të pashmangshme për të ruajtur raporte të mira me të tjerët. Madje, mund të thuhet se çdo bashkësi gjuhësore përdor si mjete që hapin komunikimin shprehje, si: *mirëmëngjesi* ose *mirëdita*, *mirëmbërëma*; *faleminderit*, *mirupafshim* (përkatësisht në italisht: *buongiorno*, *buonasera*, *grazie*, *arrivederci* ose *arrivederLa*). Pra, në këto raste shohim mënyra të thëni a struktura që ndryshojnë ndjeshëm nga kultura në kulturë. Shpeshherë, dallimi i këtyre strukturave apo mënyrave të të shprehurit vërehet edhe nga një rajon në tjetrin, prandaj një studim i imët i tyre është frytdhënës në studimet etnologjike dhe gjuhësore, sigurisht duke njohur kurdoherë edhe situatat e ndryshme të komunikimit të një apo disa bashkësive shoqërore, qofshin këto kombëtare, etnike apo rajonale. Por, deri më sot mungojnë studime përshkruese dhe krahasuese në fushën e etnografisë së komunikimit (duke iu referuar terminologjisë së përdorur nga *Dell Hymes* për studimet europiane e më gjerë dhe atë të prof. Gj. Shkurtaç për shqipen), prandaj studimi ynë, i ndërmarrë nga në kuadrin e një studimi doktorate e me mëtime jo vetëm përshkruese, por edhe përplasëse e kontrastive të lëndës nga dy gjuhë në kontakt: të shqipes dhe italishtes, synon pikërisht të vërë në dukje se në çfarë mase e shkalle njohja dhe përdorimi i këtyre strukturave mund të jenë thelbësore për mbarëvajtjen e jetës në bashkësi dhe, për më tepër, sa dhe si

këto struktura, ndonëse janë pjesë e së njëjtës hapësirë semantike, mund të diferencohen pjesërisht apo tërësisht nga një kulturë në tjetrën. Më shumë sesa zbatimi rigoroz i një renditjeje të formave të mirësjelljes të një gjuhe, neve na u duk interesante kryerja e një studimi krahasues midis italishtes dhe shqipes, si dy gjuhë që, ndonëse nuk janë të një familjeje, sepse nuk kanë lidhje birërie me njëra-tjetrën, porse janë gjuhë europiane e me pikëtakime të hershme edhe si gjuhë në kontakt, kanë shumë forma të përbashkëta të të shprehurit, si nga këndvështrimi tipologjik, ashtu dhe për sa i përket etnografisë së komunikimit. Ndërkaq, shqyrtimi i hapët i lëndës, qoftë në fushën e përhëndetjeve, qoftë edhe të urimeve, mallkimeve etj. na bën të mundur të shohim se ekzistojnë edhe shprehje e forma gjuhësore të mirësjelljes shumë të ndryshme ose ka të tilla që nuk gjejnë as përputhje, as motërzime në ndonjërin prej tyre. Për shembull, në shqip ekzistojnë forma përshëndetjeje të tipit *tungjatjeta* (geg.: *tungjatjeta*, *t'u ng-jatjeta*, *tyetjeta* ose thjesht *tjeta*; tosk.: *tungjatjeta*, *tunjatjeta*, *njatjeta*), ose në formë të shkurtuar (*tung*) shumë e përdorur kohët e fundit në gjuhën e *chat-it*, struktura që në të vërtetë nuk ekzistojnë në italisht dhe, madje, as që mund të përkthehen dhe del e nevojshme të parafrazohen e të jepen me ndonjë përshëndetje tjetër. Për më tepër, ndërsa në italisht, në mbrëmje dhe, përgjithësisht *pas orës 18.00*, përcillen me: *ciao*, *arrivederci*, o *buona serata*, në shqipen përdoret: *natën e mirë, që i përgjigjet buonanotte* në italisht.

Për të pasur një ide më të qartë, do të ndalemi mbi një tabelë të përshëndetjeve kryesore të italishtes, sipas përdorimit që ato gjejnë gjatë orëve të ndryshme të ditës, duke vendosur përbri edhe përkthimin ose termin përkatës në shqip. Për të mos humbur kohë, por edhe për t'u bazuar mbi një strukturë të njohur e të eksperimentuar më parë, për pjesën e shqipes na u duk e përshtatshme të niseshim nga lënda që na servir studiuesi Gj. Shkurtaç në librin e tij "*Onomastikë dhe etnolinguistikë*"^[1]

1. Formulatat e mirësjelljes në tërësi kanë funksionin e të shprehurit të një mesazhi (një përmbajtje, ndjenjë respekti, simpati, falënderim, mirënjohje etj.), në një situatë të caktuar ku ndihet nevoja për të shprehur diçka. Qëllimi i tyre, pra, është

[1] Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tirana, 2001.

lehtësimi, pikërisht sepse bëhet fjalë për fraza të parapërgatitura të shkëmbimit me fjalë. Siç shprehet Patrizia Perini, “*format janë të konvencionalizuara për sa u përket katër aspekteve: intonacionit, strukturës, kontekstit të duhur dhe funksionit gjuhësor e social që luajnë*”^[2]. Edhe Otto Jesperseni, gjuhëtar i njohur, që ka studiuar format e mirësjelljes, në librin e tij “*The Philosophy of Grammar*”^[3] vendos kundër tyre të ashtuquajturat (*free expressions*), duke i klasifikuar të parat si diçka që në instinktin tonë të të folurit shfaqet si një e tërë e paanalizueshme, gjë që, përkundrazi, nuk vihet re në disponibilitetin e studimit të shprehjeve të lira. Këto forma të konvencionalizuara ose “rituale” pushtojnë çdo ditë shkëmbimet tona verbale ndërpersonale. Disa forma shprehin mirësjellje, të tjera mbartin të vetmin funksion të të komentuarit të asaj që flitet gjatë një bisede, si p.sh. në italisht: “*A chi lo dici!*” ose “*Senti chi parla!*”, ndërsa në shqip shprehjet sinonimike me to do të ishin: “*Kujt ia thua?*” ose “*Shih kush flet!*”. Do të ndalemi gjatë këtij studimi kryesisht të format e mirësjelljes si mbartëse të një roli shumë të rëndësishëm në shkëmbimet verbale të shoqërisë së sotme. Ervin Gofman thotë pikërisht se “*në çdo shoqëri, në çdo rast që lind mundësia fizike për shkëmbime verbale, duket se hyn në përdorim një sistem i tërë shprehish, kushtesh dhe rregullash procedurale që funksionojnë si mjet orientimi e organizimi për fluksin e mesazheve*”^[4]. Kur kryejmë shkëmbime verbale të përditshme, u drejtohem formave e mënyrave tona të të shprehurit të grumbulluara në vite, mbështetja në to bëhet në mënyrë të ndërgjegjshme, por, në shumicën e rasteve, u referohemi këtyre strukturave standarde në mënyrë të menjëhershme dhe të pandërgjegjshme, si p.sh. në it. *Buon compleanno!* (shqip: *Edhe njëqind vjeç!* ose “*Gëzuar ditëlindjen!*”); në it. *Condoglianze!* (shqip: *Ngushëllime!* ose *Të rroni vetë!*) etj.

Por, për rolin thelbësor të këtyre strukturave do të ndërgjegjësoheshim më shumë nëse, të ndodhur në një vend të huaj, do të kemi nevojën e të shprehurit në një gjuhë që s’është e jona. Dhe ka shumë mundësi që në të tilla raste, kur nuk njihet

^[2] Patrizia Perini, 1983, *Struttura e uso di alcune formule di cortesia*, in F. Orletti (a cura di), *Comunicare nella vita quotidiana*, Bologna, Il Mulino.

^[3] Otto Jespersen, *The Philosophy of Grammar*, 1924.

^[4] Erving Goffman, 1971b, *Modelli di interazione*, a cura di P.P. Giglioli, Bologna, Il Mulino.

forma e duhur për përdorim në përputhje me situatën, ndodh që të kuptojmë rëndësinë e përdorimit të formave të mirësjelljes, zgjedhja e përshtatshme e të cilave bën që të ndihemi mirë dhe pjesë aktive në ngjarje. Do të shqyrtohen në vazhdim dy grupe formash mirësjelljeje: përshëndetjet (hapëse ose të kontaktit të parë dhe ato përmbyllëse ose përcjellëse, që duhen thënë në çastin e largimit a ndarjes) dhe urimet e veçanta a specifike, duke bërë edhe përqasjen e formave a formulave të italishtes me shqipen.

2. Funkzioni i përshëndetjes. Përshëndetja mund të konsiderohet si një lloj hapeje dhe mbylljeje e bisedës që ndodh midis dy bashkëbiseduesish. Në rast se kontakti do të ishte kalimthi (*en passant*), siç ndodh, p.sh., në një takim të rastësishëm në rrugë, atëherë përshëndetja midis bashkëbiseduesve mund të jetë edhe thjesht me gjeste dhe jo me fjalë. Goffman-i pranon se përshëndetjet hapëse ose parësore kanë qëllim të verifikojnë efektivitetin dhe pandryshueshmërinë e marrëdhënieve të mëparshme midis dy bashkëbiseduesve duke iu referuar takimit të tyre të fundit, ndërsa përshëndetjet mbyllëse ose finale përmbledhin efektet e takimit mbi marrëdhëniet personale dhe pritshmërinë e bashkëbiseduesve në një takim të radhës. Përshëndetjet hapëse ose hyrëse, përveç shprehjes së dëshirës për të shfaqur simpati kundrejt marrësit (bashkëfolësit), kanë dhe një tjetër funksion: atë të të përcaktuarit të një hierarkie marrëdhëniesh midis pjesëtarëve. Kombinimi i këtyre dy varianteve krijon një shumëllojshmëri formash respekti, si fjala vjen, dallimi formal dhe joformal, p.sh., në italishten midis *buongiorno* dhe *ciao* apo midis *arrivederLa* dhe *arrivederci*; po edhe në gjuhën shqipe dallimi midis formave sinonime për nga domethënia, por jo identike për nga funksioni e stili: *mirëmëngjesi* / *mgjesi* / *mjesi* / *gjesi*.

Përshëndetja varion në bazë të disa faktorëve sociogjuhësorë, nga të cilët më të rëndësishmit janë:

- 1. numri i bashkëbiseduesve**, që në italisht përcakton formën ("arrivederLa" në njëjës, në vend të "arrivederci" që përdoret dhe në prani të shumë personave), ndërsa në shqip këto dallime nuk ekzistojnë. *Mirupafshim*, në shqipen është si kur ia drejtojmë një personi, si kur u drejtohem disave;
- 2. moshë, gjinia dhe raporti shoqëror** midis folësve;

3. **Iloji i përshëndetjes:** hapëse, mbyllëse ose “en passant”;
4. **kanali i transmetimit** (ballë për ballë, me telefon, me letër, e-mail, chat etj.);
5. **përdorja e regjistrave** të ndryshëm gjuhësorë (formal, joformal, dialektor);
6. **çasti ose vakti** i ditës apo i natës, kur përdoret përshëndetja e caktuar (mëngjes, mesditë, pasdite, buzëmbremje, natë);
7. **kombinimi i dy ose më shumë prej** këtyre **alternativave** përcakton praninë e një morie përshëndetjesh të ndryshme. Më poshtë do të ndalemi kryesisht në përshëndetjet standarde, duke lënë mënjane zhargonet ose dysorët dialektorë dhe, natyrisht, duke synuar të nxjerrim në pah dallimet në përdorim midis gjuhës standarde italiane dhe shqipes standarde, në pamundësi për ta rrokur krejt gamën e hapësirave krahinore e dialektore të këtyre dy gjuhëve, gjë që, sigurisht, do të ishte me vlerë, porse edhe e gjerë e në përmasa që shkojnë përtej synimeve tona në këtë shqyrtim përqaesë.

2.1. Përshëndetjet e takimit. Në gjuhë të ndryshme, siç ndodh dhe me italishten e shqipen, ekzistojnë tipologji të ndryshme përshëndetjesh në varësi të kohës se kur vihen në përdorim. Ekziston, në fakt, dallimi midis *buongiorno* / *buonasera* në italisht, ashtu si *bonjour* / *bonsoir* në frëngjisht dhe kështu edhe për gjuhë të tjera dhe për shqipen: *mirëmëngjesi* / *mirëmbrema*.

Në italisht, gjithsesi, ndarja e ditës në “ditë” dhe “natë” s’është kaq e lehtë, duke pasur parasysh se nuk ekziston një përshëndetje e veçantë për pasditen, pra për atë pjesë të ditës midis mesditës dhe perëndimit të diellit, çasti se kur mund të fillojë të përdoret *buona sera* “*mirëmbrema*” varion nga Veriu në Jug të Italisë dhe, madje, shpesh varet nga zgjedhja personale e folësit. *Buongiorno* (në shqip: *mirëdita* ose *mirëmëngjesi*) si përkufizim është një përshëndetje uruese, sidomos në mëngjes ose përgjatë orëve të para të ditës, ndërsa *buonasera* përdoret si përshëndetje uruese në pasdite dhe në mbrëmje. Studiuesi italian Nino Arcuri^[5] ka ideuar një skemë në të cilën ndan harkun kohor të një dite nga agimi në mbrëmje në **tri hapësira** a çaste: mëngjes, pasdite dhe

^[5] Nino Arcuri, *Il saluto e i suoi rituali dall'antichità ad oggi*, in *Quaderni di Semantica* /a. XXI, n.1, giugno 2000.

mbrëmje. Kjo ndarje, ndërkaq, varion lehtësisht në zona të ndryshme të Italisë (Veri, Toskanë, Jug dhe Sardenjë) dhe është shumë me rëndësi të vërehet se, si p.sh., në Sardenjë mbas orës 14:00 nuk ekziston një hapësirë kohore e konsideruar si pasdite, por kalohet menjëherë në mbrëmje. Ja sepse s'është e pazakontë të dëgjohet ndokush që në pasditen e parë të përshëndetet me bashkëbiseduesin e tij me *buonasera* (shqip: *mirëmbrëma*). Gjuhë të tjera, p.sh. si shqipja, anglishtja dhe gjermanishtja realizojnë një ndarje të mëtejshme të ditës, duke përfshirë në të një përshëndetje të veçantë për pasditen: "*mirëmëngjesi*" përdoret nga dalja e diellit deri në mesditë; "*mirëdita*" nga mesi i ditës deri nga ora 18:00, kurse më pas, nga ora 18:00 deri në orën 20:00 përdoret "*mirëmbrema*". E njëjta gjë ndodh me anglishten: *good morning / good afternoon / good evening* ose me gjermanishten: *gutën Morgen / gutën Tag / gutën Abend*. Kemi përmendur edhe më sipër se si në italisht nuk ekziston një përshëndetje e mirëfilltë e barasvlershme a ekuivalente me "*buon pomeriggio*", ndonëse kohët e fundit, në një nga emisionet e pasdrekës në RAI-1 ("*Vita in diretta*") ka filluar të përdoret *buon pomeriggio* nga gazetari që drejton emisionin, kur përshëndet shikuesit dhe dëgjuesit në hapje të emisionit. Megjithatë, sikundër u tha, në italishten standarde struktura më e përdorur për përshëndetjet është: mbiemër cilësor (*buono / buona*) + emër (*buongiorno, buonasera*); krejt ashtu si në shqipen (*mirëdita, mirëmbrëma*). Por, sikundër do ta shohim më konkretisht, te përshëndetjet e përcjelljes ose përmbyllëse (*buonanotte*) mbiemri "*buono*" (i, e mirë) në italishten vjen në fillim të fjalës së përbërë, kurse në shqipen, përkundrazi, mbiemri vjen pas emrit: *natën e mirë*. Në vazhdim do të shohim se si mbiemri "*buono*" në italishten përdoret për të formuar edhe tipa të tjerë urimi, ndërsa në shqipen përshëndetja formohet sipas skemës: emri i çastit të ditës gjatë të cilit realizohet përshëndetja + mbiemri (i, e) mirë, si p.sh. në dialektin geg *natja e mirë / natja e mirë* (në standard: *mirëmëngjesi*); *mbramja e mirë* (standard: *mirëmbrëma*); grupi i parë bën pjesë në gegërisht, ndërsa i dyti në toskërisht, edhe pse përdoret jo rrallë edhe në zonat e Shqipërisë Veriore. Në italishten, përgjigjet ndaj një përshëndetjeje të tipit: takim formal (zyrtar) janë të ashtuquajturat përgjigje (-eco), d.m.th. ripërsëritet e njëjta përshëndetje e përdorur nga folësi i parë, por këtë herë nga kthyesi (a marrësi). Ndonëse

mund të ndodhë që të ekzistojnë disa variante për këtë skemë të paracaktuar, p.sh. kur shkëmbehen përshëndetje midis një titullari dhe një vartësi, apo midis një profesori dhe një studenti. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për shqipen ku përshëndetjeve: *mirëmëngjesi, mirëdita, mirëmbërëma* u përgjigjen duke përsëritur përshëndetjen e marrë më parë. Më lart jemi ndalur në përshëndetjet formale, por duhet të themi se ekzistojnë edhe forma të tjera përshëndetjeje, në kontekste joformale. Të tilla janë, p.sh., në italishten *ciao* dhe *salve*. Fjalori etimologjik^[6] përkufizon “ciao” si një përshëndetje miqësore dhe mjaft konfidenciale, kur takojmë dikë, ose kur largohemi prej tij, ndonëse “ciao” është formë përshëndetjeje e italishtes veriore, e ardhur nga dialekti venecian (*schiao*), porse sot e shtrirë kudo dhe është një formë përshëndetjeje joformale, në dallim nga *buongiorno* që përdoret si përshëndetje takimi ashtu edhe largimi (përcjellëse). Fjala “salve” vjen nga latinishtja (salvere) dhe mbart kuptimin: të jesh mirë. Kjo përshëndetje është e barasvlershme dhe e shkëmbyeshme me “ciao”, por nuk përdoret dendur si përshëndetje përmyllëse.

Për sa i përket gjuhës shqipe, mbi të gjitha, duke iu referuar përshëndetjeve joformale të përdorura nga të rinjtë, në studimet më të reja të sociolinguistikës shqiptare thuhet se në dhjetëvjeçarët e fundit është vënë re një shkurtrim i formave të përshëndetjes sidomos në hapësirën urbane, ndërsa në fshatra vijon të ruhet më mirë rituali i zakonit të të përshëndeturit tradicionalisht. (shih: Gj. Shkurtaç, vep.cit.) Të rinjtë përshëndeten midis tyre me një “ç’kemi?” (që në italishten i përgjigjet: “ciao” ose “come va”). Ekzistojnë, gjithashtu, disa struktura të tjera përshëndetjesh, që nuk janë të lidhura me një çast të caktuar të ditës, por me një situatë a gjendje psiko-fizike të atij që i drejtohem, si p.sh. *benalzato*, kur dikush sapo është zgjuar dhe përdoret për t’i uruar zgjim të mbarë. Në shqipen kjo përshëndetje jepet me pyetjen përshëndetëse: *Si u gdhive?* (në toskërisht dhe në gjuhën standarde) ose *Si ke(ni) njuh?* (në gegërisht). Duhet të themi se ky tip pyetjeje nuk gjen një barasvlerës (ekuivalent) të saktë në gjuhë të tjera, si italishtja, sepse nuk bën pjesë në kodin e tyre etnografik. Të përdorshme dendur në italishten janë: “bentornato”, si përshëndetje ndaj atij

^[6] M. Cortellazzo - P. Zolli, *Dizionario etimologico della lingua italiana (DELI)*, 5 voll., Bologna, 1979-88.

që kthehet pas një mungese, dhe ka si gjegjëse “bentrovato”; ndërsa “benvenuto” përdoret si përshëndetje për të shprehur një mirëseardhje (mikpritje) ndaj atij që vjen. Forma e shqipes “mirëserdhe” ka të njëjtin funksion si “benvenuto”, ndërsa përgjigja për këtë përshëndetje është “mirë se ju gjeta”. Në shqip përdoret shumë edhe urimi i përcjelljes: *mirardhsh* (nj.), *mirardhshi* (sh.), që do të thotë “je i mirëpritur sa herë do të vish përsëri”, por që, në italishten nuk ka një barasvlerës dhe do të mund të përkthehej përafërsisht me “sarai sempre gradito”.

2.2 Përshëndetjet përcjellëse. Këto përshëndetje zakonisht bëjnë mbylljen e një bisede, ndryshe nga të sipërpërmendurat që hapin një bashkëbisedim. Ndërsa përshëndetjet shumë shpesh janë të kushtëzuara nga çasti i ditës, përshëndetjet përmbjellëse (përcjellëse) janë të vlefshme për tërë hapësirën kohore të një dite. Përshëndetja më e përdorur në italisht është “arrivederci” (shqip: mirupafshim). Natyrisht që italishtja pasqyron dukshëm dy mënyra të ndryshme të të referuarit kundrejt bashkëbiseduesit (formale dhe joformale): krahas “arrivederci” që është forma e përdorur si në kontekstin formal, ashtu dhe në atë joformal, ekziston një formë më e rafinuar pikërisht kur i drejtohem dikujt me “kortezi”, duke i dhënë vetën e tretë (Lei) “arrivederLa”. Është interesante të vërehet më tej se “arrivederLa” është e vetmja që i referohet një bashkëbiseduesi të vetëm, në dallim nga format e tjera, si *arrivederci*, *ciao*, *buonanotte*, që mund t’u referohen një ose më shumë bashkëbiseduesve. Në anglisht, p.sh., ky dallim nuk ndodh, po ashtu si edhe në shqip. E vetmja formë ndarjeje (përcjelljeje) që ekziston në shqip, është *mirupafshim*, që përdoret si në italisht, në çdo çast të ditës dhe qoftë në situata formale, qoftë joformale, dhe mund t’u referohet një ose me shumë bashkëbiseduesve. Krahas “mirupafshim” në rajone të ndryshme të Shqipërisë përdoren dhe sinonime të së njëjtës strukturë e tipologji, por me përbërje leksematike të dallueshme, si: *mirupjekshim*, *mirutakofshim*, apo në Veri *u pafshim me të mirë!*, ndërsa në italishten “*buonanotte*” është një përshëndetje uruese përcjelljeje, që shqiptohet duke u ndarë në orë të vona ose para se të shkojmë në shtrat dhe në asnjë kontekst tjetër.

Shkurtimi “*notte*” përdoret në kontekste personale e në rrethe

intime, ashtu si “*natën!*” në shqip, përndryshe, kur ndahemi në mbrëmje, përdoret forma e plotë: *natën e mirë!* Në italishten *buonanotte* përdoret në një kontekst më të kufizuar, pikërisht në mbrëmjen e vonë, ose para se të biem të flemë, kurse në shqip përdoret gjerësisht që pas orës 20:00. Një tjetër formë përshëndetjeje që shfaq disa variante, është *ti saluto*)joformale që bëhet *La saluto* në një kontekst formal me një bashkëbisedues, dhe *vi saluto* në praninë e më shumë bashkëbiseduesve. Në shqip ekziston një formë e ngjashme të *fala*, që më parë gjente goxha përdorim (*bëj të fala; falëmshëndet*). Përshëndetja përcjellëse joformale më e zakonshme është “*ciao*”, që, si e kemi parë, mund të hapë edhe një takim verbal. Në këtë kontekst, “*ciao*” përdoret edhe e përsëritur *ciao-ciao*, si shprehje e një afiniteti a afërsie më intime. Në shqipen, si u tha edhe më sipër, përdoren *mirupafshim* ose *mirupjekshim* dhe *mirutakofshim*, si në rastin kur kemi shumë afërsi a intimitet midis bashkëbiseduesve, por midis të rinjve mund të përdoren edhe shkurtime të *pafshim* ose *paçim*, madje edhe *pao!*

Një tjetër përshëndetje joformale në italisht është *stammi bene*, që ekziston në shqipen (*qofsh mirë*), porse, me sa duket, në standard nuk ka pasur shumë përdorim. Një formë e ngjashme me italishten duket se përdoret nga arbëreshët e Italisë (*rri mirë / rrini mirë*) dhe mund të shihet si një ndikim a kalk strukturor sipas italishtes (*stammi bene*).

Ekzistojnë më tej me mijëra forma përcjellëse që i referohen çastit të një ritakimi të mëvonshëm midis bashkëbiseduesve (*a presto, a più tardi, a domani, alla prossima settimana* ose thjesht *alla prossima*), duke lenë të paqartë çastin se kur do të mund të ritakohen, të ngjashme me formën *see you soon* në anglishten apo *bis dann* në gjermanisht. Në shqip përdoren me atë kuptim e vlerë shprehjet: *me të mira, hajt gjithë të mirat, qofsh (i,e) mirë*, dhe, së fundmi, *shihemi apo shihna* në gojën e më të rinjve dhe, pa dyshim, si ndikim e kalkim i anglishtes (*see you*).

Në italisht, e vetmja përshëndetje që realizon një përcjellje përfundimtare, është *addio*, në dallim nga “*ciao*” apo “*arrivederci*” që shprehin një largim të përkohshëm. Megjithëse përdorimi i kësaj forme pak nga pak po humbet efikasitetin, sepse në shqipen ka pasur përdorim dhe ekziston gjithashtu një formë e ngjashme *lamtumirë “addio”*, që përdoret pikërisht kur parashikohet

mungesa përfundimtare e ndonjë takimi me personin të cilit i drejtohet shprehja, për këtë arsye *lamtumirë* “addio” përdoret pothuajse vetëm për rastet kur dikush ndahet nga jeta. P.sh., sot i dhamë *lamtumirën* e fundit zotit...

Përgjigjet ndaj përsëritjeve të largimit, zakonisht si në italisht, ashtu dhe në shqip përbëhen nga një përgjigje e njëjtë; kjo vlen në italisht për *ciao, arrivederci, addio o buonanotte*, ndërsa në shqip është e vlefshme për *mirupafshim, natën e mirë, lamtumirë*, për sa u përket përgjigjeve për format *ti saluto / la saluto, stammi bene* dhe ato të cilat i referohen një ritakimi në të ardhmen, janë të ndryshme si në italisht dhe në shqip.